

**ENTELE KORE**

**ÇAMËRISHTJA DHE RËNDËSIA E STUDIMIT TË SAJ  
NË STUDIMET DIALEKTOLOGJIKE**

Objekt i punës sonë do të jetë çamërishtja dhe rëndësia e studimit të saj në studimet dialektologjike shqiptare. Çamërishtja, kjo e folme mjaft origjinale, është cilësuar hera-herës nga studiues të ndryshëm si ‘dialekti arkaik i shqipës’<sup>1</sup>. Këtij gjykimi dhe interpretimi interesant i jemi përmbajtur edhe ne, kur kemi trajtuar elemente të veçanta të këtij nëndialekti, siç janë tiparet fonetike dhe morfologjike që mbart kjo e folme. Të trajtosh dhe përvijëzosh në këto pak faqe rëndësinë e kësaj së folmeje, jo vetëm në studimet dialektologjike, por edhe më gjerë, do të ishte e pamjaftueshme, pasi vlera dhe rëndësia që mbart kjo e folme në kuadër të studimeve dialektologjike, është më e gjerë.

Për të nxjerrë përfundime dhe shpjegime të sakta për të folme të veçanta të shqipës, çdo gjuhëtar duhet ta vështrojë atë sinkronikisht dhe diakronikisht. Vetëm duke e parë në këtë pikëvështrim mund të nxjerrim konkluzione me vlera të rëndësishme për këto të folme. Kështu që, çamërishten e kemi vështruar në aspektin diakronik dhe sinkronik për të parë evolucionin e kësaj së folmeje, por edhe risitë që paraqet në raste të veçanta. *Materialet dialektore janë një burim mjaft i rëndësishëm që orientojnë gjithmonë studiuesin për shpjegimin e fjalëve të ndryshme, kuptimet, trajtat dhe format e fjalëve, shtrirjen dhe lidhjet brënda dhe jashtëgjuhësore*<sup>2</sup>, - shprehet studiuesi K. Topalli. Për të kuptuar vlerat e kësaj së folmeje, bazuar në materialin e pasur e të gjerë që përmban kjo e folme, po vëmë në dukje rëndësinë që ka çamërishtja në studimet dialektologjike.

---

<sup>1</sup> Term i përdorur nga Enver Kushi.

<sup>2</sup> K. Topalli, *Materiale dialektore në ndihmë të etimologjisë*, Mehmet Çeliku – Personalitet i gjuhësisë shqiptare, Tiranë, 2016, f. 203.

E folmja çame edhe në ditët e sotme ruhet me fanatizëm nga bartësit e origjinës,<sup>3</sup> paraqitet si një nga nëndialektet më tipike të gjuhës shqipe. Për shekuj me radhë ka qenë si një gadishull, në një mjedis gjuhësor biling, gjithnjë në përpjekje të ruajtjes së identitetit social dhe etnik shqiptar.<sup>4</sup> Për fizionominë e veçantë që ka kjo e folme si dhe vlerat e saj, ka tërhequr rreth vetes studiues, udhëtarë, diplomatë e konsuj të huaj. Gjuhëtarë e filologë si Çabej, Demiraj. Q. Haxhihasani, kanë nxjerrë prej saj përfundime të rëndësishme për historinë e shqipes, të cilat përforcojnë lidhjet e gjuhës së sotme shqipe me gjuhën ilire apo para ilire.<sup>5</sup>

Eqrem Çabej është një ndër emrat më të rëndësishëm në fushën e studimeve etimologjike. Në çdo studim apo punim shkencor për çamërishten, nuk ka si të mos bjerë në sy referimi që i bëhet prof. Çabejt për të ‘famshmin’ *shpjegim etimologjik* rreth emrit të krahinës së Çamërisë. Nëpërmjet shpjegimeve të tilla kemi arritur t’i shkojmë shqipes në kapërcyell, duke shpjeguar hap pas hapi evolucionin e çdo fjale. E. Çabej është i pari albanolog shqiptar i përmasës ndërkombëtare i cili falë punës kolosale arriti të vendosë gjuhën shqipe në themelet e vazhdimësisë ilire.<sup>6</sup> Këtë traditë pune studiuesi i nderuar do vazhdonte dhe për shpjegimin e emrit të njërës prej krahinave me fatkeqe të Shqipërisë, pikërisht, Çamërisë, e cila iu shkëput padrejtësisht trungut të saj. Lidhur me shpjegimin që bën Çabej për lidhjen e ngushtë të emrit të krahinës me lumin që përshkon atë, mbetet një ndër tezat kryesore sot për sot në studimet shqiptare, të cilin e kanë mbështetur dhe historianë, gjeografë e studiues të ndryshëm. Sipas tij, Çamëri vjen nga zbërthimi fonetik i fjalës **Thyam-Çam**, duke ndjekur kështu një vijë të saktë logjike e shkencore në bazë të ligjësisë fonetike. Në punimet e prof. Çabejt, vazhdimësia e këtyre dy termave (Thyamis-Çam) shpjegohet në bazë të ligjeve të zhvillimit fonetik të shqipes. Mbështetur në këtë fakt, ai e paraqiti emrin Çamëri si një nga emrat tipik që vërtetojnë autoktoninë e shqiptarëve në vendbanimet e tyre të sotme. Sipas tij, edhe zhvillimi fonetik Archthos (emri i lashtë i

<sup>3</sup> Ruajtës dhe përdorues të rregullt kemi brezin e tretë, por elemente të saj shfaqen edhe në brezin e mesëm dhe të ri. Duhet të theksojmë se dy brezat e fundit kanë prirjen drejt standardit.

<sup>4</sup> S. Sheme, *Çamëria – Vështrim gjeopopullativ dhe etnokulturor*, Tiranë, 2016, f. 268.

<sup>5</sup> *Po aty*, f. 269.

<sup>6</sup> Përkufizim për prof. Çabej, marrë nga pasthënia e librit *Shqipja në kapërcyell*.

qytetit të Artës) shpjegohet më mirë me anë të shqipes se sa greqishtes.<sup>7</sup> Përveç shpjegimit që ky studiues jep për emrin e krahinës, me interes për studimet dialektologjike dhe më gjerë, vlen të përmendim edhe shpjegimin e disa fjalëve të tjera nga kjo e folme. Rëndësi të veçantë në fushën e studimeve etimologjike paraqet dhe shpjegimi e fjalës *shklata* nga E. Çabej. Sipas tij, shklata është një fjalë vendi që ngjason me lidhëza e adverbe që janë formuar në fillim të fjalisë (në sandhi), *si as, çka, dot druese, mbase, ndiç, pondë, sos*<sup>8</sup>. Shklata është formuar nga aglutinimi i tre përbërësve *sh +kle+ata* (ç'që ajo punë), që në Gjirokastër përdoret *ç'qe ata?*, me përemrin dëftor të neutrit shprehet Çabej. Ky shpjegim gjen mbështetje edhe ndër studiues të huaj, veçanërisht nga Pedersen.

Qemal Haxhihasani është padyshim figura qendrore në mbarë studimet dialektologjike me të cilin zë fill studimi i çamërishtes. Vepra e këtij studiuesi që ka punuar me zell të madh për këtë të folme dhe veçoritë e saj, do të mbetet udhërrëfyese kryesor jo vetëm i punimit tonë, por edhe për studiuesit e mëvonshëm që të duan të studiojnë këtë të folme. Falë punës dhe përkushtimit të tij si dialektolog, falë kërkimit dhe hulumtimit të vazhdueshëm, njëkohësisht përmes hetimeve dhe anketimeve dialektologjike, ka arritur të na japë një vepër madhore për të folmen çame. Ne këto punime që dëshmohej më së miri e folmja origjinale dhe arkaikë e çamëve, gjendet një thesar gjuhësor i mirëshpjeguar dhe interpretuar i kësaj së folmeje. Në të tria vëllimet për Çamërinë, përmendim këtu Dialektologjia Shqiptare I, II dhe III<sup>9</sup>, studiuesi na jep një interpretim dhe shpjegim gjuhësor të saktë rreth veçorive të kësaj së folmeje. Duke filluar punën madhore që tek *Dialektologjia Shqiptare I*, që mban dhe titullin *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, dhe deri tek Dialektologjia Shqiptare III, mund të themi se kemi të bëjmë me një monografi të posaçme për këtë të folme. Punimi i tij fillon me një panoramë historike dhe gjeografike rreth Çamërisë dhe historisë së shpërnguljes së tyre, më tej autori na jep veçoritë gjuhësore duke filluar me theksin, zanoret bashkëtingëlloret e më gjerë. Hapësirën më të madhe e

---

<sup>7</sup> E. Çabej, *Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve*, BUSH, 1958, f. 10-12.

<sup>8</sup> E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XX*, SF, nr. 1, Tiranë, 1966, f. 24.

<sup>9</sup> *Dialektologjia Shqiptare*, seri me përmbledhje studimesh dialektologjike, që botohet që prej v. 1971 nga sektori i gramatikës dhe i dialektologjisë i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (Për më tepër, shih Fjalori enciklopedik shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, vëll. I, Tiranë, 2008).

zënë veçoritë në sistemin emëror, foljor dhe ndajfoljor (dhe pjesët e tjera të ligjëratës janë analizuar), por, duhet të theksojmë që në këtë kapitull, një vend të rëndësishëm zënë dhe shndërrimet fonetike. Në punimin e dytë (që autori ka botuar në Dialektologjinë Shqiptare II) autori na jep një pasqyrë të shkurtër rreth mënyrave dhe formanteve të fjalëformimit. Për sa i përket fjalëformimit, në këtë të folme gjejmë mjaft formante interesante, përmendim këtu prapashtesën **-shim** dhe **-çim** për formimin e mbiemrave në këtë të folme në fjalë si: *i friksuaçim, i nderçim, i kollajshim*<sup>10</sup>. Të njëjtën prapashtesë kemi hasur edhe në gjuhën e Buzukut, ku kjo prapashtesë del në formimin e këtyre mbiemrave: *i diçim, i duruoshim, i dhunuoshim*.<sup>11</sup> Nisur nga këta shembuj, mund të themi se, njësitë e reja leksikore të formuara me prapashtesa, tregojnë për një tjetër veçori të përbashkët mes çamërishtes dhe autorëve tanë të vjetër, ku spikat gjuha e Buzukut “Meshari”.

Përveç rrugëve e mënyrave të fjalëformimit që ndjek e folmja çame, një fushë mjaft e vështirë siç është ajo e sintaksës gjendet e pasqyruar në vazhdim të këtij punimi. *Sintaksa dialektore*, siç e thekson dhe vet autori, është fushë e vështirë që kërkon kërkime të gjata dhe kujdes të madh për të dalluar çka është e gjuhës popullore të folur në përgjithësi e çka është vërtet dialektore...<sup>12</sup> Pas sintaksës, në vazhdim të punimit mbi Çamërinë, autori ndalet tek *fjalori*, një element mjaft domethënës për këtë të folme, duke na dhënë fjalë të veçanta me origjinë çame nga fusha të ndryshme. Dhe për ta mbyllur studimin madhor mbi të folmen çame, autori na jep një informacion të plotë nga toponimia e Çamërisë. Nga sa parashtroam më sipër, mund të themi se ky punim përbën një ndër monumentet më të vyera në kuadër të studimeve dialektologjike shqiptare me karakter te plotë gjuhësor.

E folmja e banorëve të Çamërisë, paraqet interes të madh për studimet dialektologjike dhe për shqyrtimet etnolinguistike, si e tillë, ka tërhequr vëmendjen e studiuesit më në zë të dialektologjisë prof. Gjovalin Shkurtaç. Për të treguar se çfarë vlere faktuese dhe ndihmuese për

<sup>10</sup> Fjalë me këtë prapashtesë kemi gjetur edhe në tekstet e Pedersenit, pikërisht në librin me titull: *Albanesische mit glossar*, Leipzig, 1895.

<sup>11</sup> Më gjerësisht për formimin e fjalëve në veprën e Buzukut, shih E. Hysa dhe L. Xoxe, *Vëzhgime për formimin e fjalëve te “Meshari” i Gjon Buzukut*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare, 22/1, Tiranë, 2004, f. 236-240.

<sup>12</sup> Shih: Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, Dialektologjia Shqiptare II, f. 11, Tiranë, 1974.

shpjegimet dhe shqyrtimet shkencore ka materiali gjuhësor që vjen nga krahinat e Çamërisë, mjafton të përmendim vetëm një fragment nga libri i profesorit “Onomastikë dhe etnolinguistikë”, ku shtjellohet dhe argumentohet emërtimi mbi bazën e numërorëve<sup>13</sup>. Në këtë libër emërtimi i moçëm “Dimal”, sipas E. Çabejt gjen shpjegim me mjete të shqipes, si “dy male”, si rrjedhim, nisur nga ky zbërthim, mund të themi se ‘Dimele e Çamërisë’ është përfutur nga dy+male dhe nga metafoia *a* në *e*. Sipas Gj. Shkurtaj, e folmja e Çamërisë është një nga ato të folme anësore të shqipes, e cila ashtu si shumë prej krahinave të tilla, që ndodhen në anët e pikat më skajore të shtrirjes së një kombi, deri aty ku ndahet kufiri me kombe e gjuhë të tjera të fqinjëve, ruan në shkallë deri diku të gjerë tipare të një faze të kapërcyer të shqipes...<sup>14</sup> Një libër me vlera të jashtëzakonshme mbetet dhe libri me titull “*Ligjërimet arbëreshë*” i profesor Gj. Shkurtaj, i cili na njeht me një material gjuhësor rreth grupeve të tjera të shqipes, siç janë të folmet e arbëreshëve të Greqisë dhe Italisë. Duke krahasuar këto të folme dhe të folmen e çamërishtes, kemi nxjerrë përfundime të rëndësishme për gjuhën shqipe në përgjithësi dhe çamërishtes në veçanti.

Përveç këtyre studimeve që kanë pasur në qendër të vëmendjes të folmen çame, mbledhje materiale dhe studime me interes janë bërë për *onomastikën* çame, ku, në mënyrë të veçantë spikat puna shumë e vlefshme që ka bërë studiuesi Fatos Mero Rrapaj.<sup>15</sup> Falë talentit që e karakterizonte dhe qëndrimit shumëvjeçar me banorë çam, arriti të vilte një fjalor të pasur të gurrës së pashtershme çame. Prej këtij autori kemi: “Këngë popullore nga Çamëria” (botim i Institutit të Kulturës Popullore, Tiranë 1983, 884 faqe). Vëllimi “Këngë popullore nga Çamëria”, për meritat e folkloristit Fatos Mero Rrapaj, sjell një material të gjerë me vlera ideestetike të begata dhe të larmishme. Janë përfshirë në të këngë për shpërthime revoltash të thella njerëzore, fshikuj satirikë, sarkazma, vargje me elemente të lashta botëkuptimore etj.<sup>16</sup> Përveç kësaj vepre solide, prej tij mund të përmendim: “Rënkimet e Çamërisë” (1995) dhe “Fjalori Onomastik i Epirit” (vëllimi I, Çamëria) prej gati 660 faqesh (1995). Sipas Gj. Shkurtaj, *një gurrë e pashtershme dhe objekt i vlefshëm studimi duhet*

---

<sup>13</sup> S. Sheme, *Çamëria-Vështrim gjeopopullativ dhe etnokulturor*, Tiranë, 2016, f. 274

<sup>14</sup> Gj. Shkurtaj, *Vlera dialektologjike dhe etnolinguistike të së folmes së Çamërisë*, në “Çështja çame dhe integrimi evropian”, Tiranë, 2005, f. 145.

<sup>15</sup> *Po aty*, f. 147.

<sup>16</sup> Shkëputur nga hyrja e kësaj vepre, shkruar e redaktuar nga Andrea Varfi.

*të jetë onomastika: emrat e viseve dhe të njerëzve, një pasuri e madhe që rrezikon të humbet në kushtet e sotme, por fatmirësisht, na është fiksuar në një fjalor, në skica e monografi dialektologjike...*<sup>17</sup> Botimi i këtij fjalori, - shprehet autori, është një dokument i pavdekshëm i cili me dhimbje do t'u kujtojë banorëve autoktonë vendet e dashura ku kaluan jetën dhe tragjedinë e dëbimit. Toponimia e Çamërisë, plotëson në një farë mënyre një boshllëk të studimeve shqiptare për të folmen çame rreth fushës së toponomastikës.<sup>18</sup> F. M. Rrapaj, rëndësinë e këtij libri e krahason me zbulimet arkeologjike.<sup>19</sup> Sipas tij, studime të tilla që kanë synim shpjegimin e çdo krahine, qyteti, mali, rruge, deti, vije, përroi lumi, pylli etj, duhet të jenë domosdoshmëri sa shkencore aq edhe atdhetare.<sup>20</sup> Krahas këtyre faktorëve që parashtrua më sipër të cilat ngrehin vlerat e kësaj së folmeje, në radhë të parë, toponomastika e Çamërisë paraqet interesa të veçanta gjuhësore e dialektologjike. Mjaft elemente të saj tërheqin vëmendjen për lashtësinë e formimit dhe si pasojë, për prejardhjen, trajtën dhe semantikën e tyre. Ato na lejojnë të thellohemi në të kaluarën apo në analiza dukurish gjuhësore, shpeshherë, më mirë sesa materialet që furnizon gjuha e përgjithshme.

Përveç figurave të lartpërmendura në fushën e studimeve dialektologjike, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre për çamërishten, një tjetër studiues ka merita të vyera për këtë nëndialekt.

*Fatmir Muça*, për një kohë të gjatë iu përkushtua studimeve për të nxjerrë në dritë punimin monografik mbi të folmen e Konispolit. Në këtë monografi, autori ndjek pak a shumë modelin e Q. Haxhihasanit duke na përshkruar kështu të folmen e krahinës së Konispolit në të gjitha rrafshet e gjuhës. Duke vrojtuar tiparet fonetike, morfologjike, fjalëformuese, sintaksore e leksikore të kësaj së folmeje, dallojmë një varg veçorish e fenomenesh të ruajtura me elemente, forma e trajta që të folmet e tjera të trullit të shqipes i kanë humbur ose i kanë ruajtur në raste të rralla. Nisur nga kjo analizë e detajuar që na jep autori rreth tipareve dialektore kësaj së folmeje konstatojmë, se e folmja çame në përgjithësi dhe e folmja e krahinës së Konispolit, kanë shumë pikëtakime dhe afri mes tyre. Një konkluzion i tillë përforcon edhe një herë tiparet e një çamërishteje të

<sup>17</sup> *Po aty*, f. 147.

<sup>18</sup> Një punim të tillë kemi dhe nga studiuesi i njohur Q. Haxhihasani mbi toponomastikën e Çamërisë, shih: *Nga topomanistika e Çamërisë*, "Dialektologjia Shqiptare", III, Tiranë, 1975.

<sup>19</sup> F. M. Rrapaj, "*Fjalori onomastik i Epirit*" (vëll. I, Çamëria), Tiranë, 1995.

<sup>20</sup> *Po aty*, f. 7-15

përbashkët, e cila edhe pse në zona të ndryshme, ruan elementin çam të padeformuar. Krahas këtij punimi mjaft interesant për të folmen e Konispolit, autori është përfshirë edhe në një sërë projektesh të tjera me vlera të mëdha gjuhësore. Në kuadër të anketimeve për Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe, nga grupi realizues i kësaj vepre madhore, janë bërë anketime të plota në disa pika që përfaqësojnë të folmen e Çamërisë dhe të banorëve të saj.<sup>21</sup>

Çamëria dhe banorët e saj, prej kohësh kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve të ndryshëm, në veçanti për shtrirjen gjeografike, identitetin kombëtar; për shqipen arkaike, mënyrën e jetesës, ngjarjet, prijësit, traditat, mikpritjen, veshjet, këngët dhe vallet etj. Për këto vlera të rralla të kësaj krahine, qysh herët udhëtarë e studiues kanë fiksuar momentet më të veçanta të kulturës popullore e shpirtërore të këtyre banorëve. Studiuesi dhe etnografi francez Erkhard, kostumet popullore të Çamërisë i konsideron si një ndër elementet më të rëndësishme të shprehjes së identitetit të tyre etnik. Ndër të tjera ai shprehet: *Veshja për gra e stilit çam e rregulluar prej artistëve të Janinës, për nga kompozicioni, është gjëja më e përkryer në formën e kostumit që unë kam parë ndonjëherë. Veshja e brendshme është prej mëndafshi ose mëndafsh përzier me pambuk e me qënare tërë ngjyra, me nuanca delikate. Veshja e jashtme, që i jep kostumit bukurinë e tij karakteristik, është një copë me ngjyrë të lehtë, por jo të çelur, si p.sh., e verdhë në kafe, kafe në gurali dhe e qëndisur bukur me gajtanë të vegjël të rrumbullakët, zakonisht në të njëjtën ngjyrë, por në një nuancë më të çelur ose më të errët se ngjyra e copës...*<sup>22</sup> Po kështu, albanologu i shquar danez Holger Pedersen, i përkushtuar rreth studimit të shqipes, na jep një kornizë të plotë rreth tipareve dialektore të kësaj së folmeje. Në librin e tij *Albanesische mit glossar* (Lepzig, 1895), autori na jep disa tekste me përralla e ndodhi ku spikatin dukshëm tiparet dhe elementet e kësaj së folmeje, të ruajtura kryesisht në banorët e zonave veriore të Çamërisë.

Si përfundim, mund të themi se rëndësia e çamërishtes dhe vlerave të saj qëndron në ruajtjen e mjaft dukurive dhe fenomeneve të hershme të gjuhës shqipe, përmendim këtu tiparet dialektore që specifikojnë këtë të folme si: ruajtjen e grupeve të bashkëtingëlloreve **kl** e **gl** në fjalët si: *klumusht, klisha, gluha, i glatë*; të gjitha dialektet e shqipes thuhet se kanë

---

<sup>21</sup> Gj. Shkurtaç, *Vlera dialektologjike dhe etnolinguistike të së folmes së Çamërisë*, në “Çështja çame dhe integrimi evropian”, f. 147, Tiranë, 2005.

<sup>22</sup> *Vep. e cit. më sipër*, f. 249.

humbur këto grupe, ndërsa nëndialekti çam e ruan në formën më të mirë këtë formë arkaike të shqipes (këto grupe sot ruhen vetëm nga brezi i tretë). Një veçori e kësaj së folmeje është dhe ruajtja e bashkëtingëllores **I** ndërzanore në fjalë si *fëmilë, bilë, golë*<sup>23</sup>; ruajtja në disa raste të zanoreve të gjata; prania e prapashitesës **ël(ë)** në formime emrash nga pjesorja e foljeve në fjalët: *ardhëla, nisëla, plasëla...* etj.<sup>24</sup>

Përveç tipareve thelbësore që diferencojnë këtë të folme, çamërishtja ka rëndësi sepse nëpërmjet materialeve të saj mund të bëhen krahasime me të folmet e arbëreshëve të Greqisë dhe Italisë<sup>25</sup>; ndër elementet e përbashkëta rreth këtyre të folmeve, vendin kryesor e zënë ngjashmëritë në fushën e fonetikës, morfologjisë e leksikut. Përveç ngjashmërive në fushën e gjuhësisë, mes çamërishtes dhe këtyre të folmeve, gjejmë disa pikëtakime edhe për sa i përket traditës popullore. E vendosur në skaj të Shqipërisë, pozita e saj shpeshherë ka favorizuar ruajtjen e këtyre fenomeneve, si e tillë ajo paraqitet mjaft konservative.

Një rëndësi të veçantë për studimet dialektologjike kanë afritë që çamërishtja ka mes të folmeve të tjera të shqipes, duke filluar me të folmen e Lumës dhe deri te ngjashmëritë që kjo e folme ka me labërishten dhe gjirokastritçen. Elemente dhe gjurmë të kësaj së folmeje gjejmë qysh herët tek autorët tanë të vjetër, ku vendin kryesor e zë Muhamet Kuçuku, me veprën Jusufi dhe Zulejhaja. Në veprat e këtyre autorëve pasqyrohet qartë çamërishtja me format e saj të veçanta, këto trajta kanë tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve për të nxjerrë përfundime të rëndësishme për gjuhën shqipe. Duke u mbështetur te këto elemente që përmendëm më sipër, por edhe tek të tjerë që e bëjnë edhe më të veçantë këtë folme, mund të përcaktojmë kështu vendin e rëndësishëm që zë çamërishtja në studimet dialektologjike. Duke u nisur nga përfundimet e mësipërme rreth elementeve gjuhësore që karakterizojnë këtë të folme, po kështu, dhe nga tradita, kultura, veshjet, mikpritja, këngët dhe vallet, mund të themi pse çamërishtja ka qenë dhe do të jetë në qendër të studimeve dialektologjike dhe më gjerë.

<sup>23</sup> Këto forma mund t'i ndeshim edhe tek të folmet arbëreshe të Greqisë dhe Italisë.

<sup>24</sup> Për më shumë rreth tipareve të kësaj së folmeje, shih punimin e plotë me titull: *Tipare fonetike dhe morfologjike në të folmen e çamërishtes*, konferencë Ndërkombëtare e Qendrës së Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2012.

<sup>25</sup> Çamërishtja është i vetmi nëndialekt i shqipes që ka të përbashkëta mes këtyre dy të folmeve jashtë truallit të shqipes.

## BIBLIOGRAFI

- Çabej, E., *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XX*, SF, nr. 1, Tiranë, 1966.
- Çabej, E., *Shqipja në kapërcyell*, Tiranë 2005.
- Frashëri, K., *Historia e Çamërisë, vështrim historik*, UETPRESS, 2015.
- Haxhihasani, Q., *Nga topomanistika e Çamërisë*, në “Dialektologjia Shqiptare”, III, Tiranë, 1975.
- Haxhihasani, Q., *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, në “Dialektologjia shqiptare”, I, Tiranë, 1971.
- Hysa, E. - Xoxe, L., *Vëzhgime për formimin e fjalëve të “Meshari” i Gjon Buzukut*,
- Rrapaj, F. M., *Fjalori onomastik i Epirit* (vëll. I Çamëria), Tiranë, 1995.
- Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 22/1, Prishtinë, 2004.
- Sheme, S., *Çamëria-Vështrim gjeopopullativ dhe etnokulturor*, Tiranë, 2016.
- Shkutaj, Gj., *Vlera dialektologjike dhe etnolinguistike të së folmes së Çamërisë*, në “Çështja çame dhe integrimi evropian”, Tiranë, 2005.
- Topalli, K., *Materiale dialektore në ndihmë të etimologjisë*, në “Mehmet Çeliku – Personalitet i gjuhësisë shqiptare”, Tiranë, 2016.
- Xhufi, P., Kuçuku, B., Isufi, H., Koçi, D., *Çamëria, vështrim historik dhe etno-kulturor*, Tiranë, 2015.

